



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.1007/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Kosova Limo SH.P.K., me seli në Ferizaj, rr.“Halil Alidemaj”, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.620/2022 të datës 30.05.2023, me datë 09.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kosova Limo SH.P.K., me seli në Ferizaj, rr.“Halil Alidemaj”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.620/2022 i datës 30.05.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.620/2022 të datës 30.05.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) me seli në Prishtinë ashtu që ka shfuqizuar Urdhri përbarimor P.nr.413/2020 i datës 22.12.2020, të lejuar nga Përbaruesi Privat Mubarak S. Shumolli.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përbarimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ashtu që të lihet në fuqi urdhri përbarimor P.nr.413/2020 i datës 22.12.2020.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kosova Limo SH.P.K., me seli në Ferizaj, rr.“Halil Alidemaj”, me datë 22.12.2020 ka paraqitur propozim për përmbarrim, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 20-SHV04-001-14 të datës 26.05.2020 në shumë prej 975.00 euro.

Përmbarruesi Privat Mubarak S. Shumolli, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin P.nr.413/2020 të datës 22.12.2020, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr. 20-SHV04-001-14 të datës 26.05.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit që rrjedh nga fatura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 975.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e përmbarrimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Kundër këtij urdhri debitorit ka paraqitur prapësim me datë 25.02.2021, duke e kundërshtuar të njëjtin në tërësi, me arsyetimin se dokumentet e bashkangjitura propozimit për përmbarrim nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm sikurse është paraparë me nenin 29 të LPP-së, pasi që fatura kontestuese nuk është bashkangjitur në origjinal apo kopje të vërtetuar. Tutje ka shtuar se kreditori nuk ka ofruar fakte se debitorit ka bërë porosi për kryerjen e shërbimeve që kreditori pretendon t’i paraqes si borxh, pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë kontratë për kryerjen e shërbimeve të pretenduara, e rrjedhimisht debitorit nuk ka asnjë obligim ndaj kreditorit, andaj ka propozuar që urdhri P.nr.413/2020 i datës 22.12.2020 të shfuqizohet. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 08.03.2021, duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke theksuar se nga fatura shihet qartë shuma e borxhit dhe e njëjta faturë është e pranuar nga ana e debitorit, fakt ky që dëshmohet nga vula e protokollit të debitorit. Ka shtuar se kreditori ka kryer punët largimi/groposja e placentave nga sallat e operacioneve klinike gjinekologjike, dhe mbi bazën e kësaj pune ka lëshuar faturën të cilën kërkon të paguhet, andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri përmbarrimor P.nr.413/2020 i datës 22.12.2020 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.620/2022 të datës 30.05.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbarrimor P.nr.413/2020 të datës 22.12.2020, të lejuar nga përmbarruesi privat Mubarak S. Shumolli, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret fatura nr. 20-SHV04-001-14 e datës 26.05.2020 në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarrim është bashkangjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbarrim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në

dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se, në bazë të nenit 21 dhe 29 të LPP-së, organi përmbarues e cakton përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm. Ndërsa me dispozitën e nenit 37 të LPP-së përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, ndërsa me dispozitën e nenit 40 të LPP-së, përcaktohet se: *“ Propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë kërkesën përmbarimore nga paragrafi 1, të nenit 38 të LPP-së”*, ku me nenin 38 paragrafi 1 të LPP-së parashihet se: *“ propozimi për përmbarim duhet të përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi...”*. Në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm për faktin se dokumenti i besueshëm - Fatura nr. 20-SHV04-001-14 e datës 26.05.2020 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i përmban të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm, ngase e njëjta nuk është në origjinal apo kopje e vërtetuar, por është vetëm kopje e pa vërtetuar nga ana e kreditorit dhe në të njëjtën kohë është e pa përmbarueshme.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë në rastin konkret, përmbarimi është lejuar në bazë të faturës e cila nuk është në origjinal apo kopje e vërtetuar dhe rrjedhimisht i bie që është në kundërshtim të plotë me dispozitat e lartcekura, andaj edhe në këtë drejtim rezultojnë si të pathemelta pretendimet ankimore të kreditorit, të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pathemelta, ndërsa aktvendimin e ankimuar vendosi ta vërtetojë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika (b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1007/2023 me datë 09.02.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova